

BIBLIOTEKA
SHTETIT

224-1

619

23/1-1

Natasha Iako

MARSi
BRENDA
NESH

VJERSHA

8P1-P83~1

L19

S

NATASHA LAKO

MARSI
BRENDA NESH

Vjersha

~~57701.~~

13174



G R U A

Poemë

Ngado që të shkoj
do të kthehem tek ti, grua;
do të doja të kthehesha tek ti
gjithmonë,
si ktheheshin pas pune burrat
dhe gjenin sobën të ngrohtë,
si kthehen fëmijët nga shkolla në shtëpi
dhe marrin një copë bukë në dorë.

[?]

Dua
të bëhem grua
dhe t'u jap dashurinë
burrit dhe fëmijëve.

[?]

Ëndrrat fillonin me pajën,
ëndrrat fshiheshin në velenxa,

ëndrrat fshiheshin në qilima me rrota
(nëpër ditët e lulëzuara të muajit
dhe në bardhësinë e ditëve të ftohta). . .

Rrota tē qerreve,
rrota tē mullinje
rrota tē qerthujve,
rrota tē qedereve. .

Shihni duart tonä,
Të shkathta kanë qenë, të palodhura,
kushedi sa lesh kanë larë çesmave të mëhallës,
kushedi sa gjyme kanë ngritur.

Na kanë këputur gjymet!
Na kanë këputur hallet!

Domin velenxë me thekë,
sepse na pëlqente bari;
të kaltrën e domin si qiellin tonë,
na dilte e shplarë.



Na thoshnin grykargjendë.
Këndonim.
Brenda kurmit tonë
ne kishim këngë miliona.

Duke qëndisur këmishë,
shtoheshin,
duke pjekur kulaç,
digjeshin
tingujt e dridhshëm.

Përrallat flisnin për qilima të pamasë
dhe për bukë që ngopte dynjanë.
Neve, grykargjende,
na mjaftonte
vetëm fillimi i një kënge:
zemrat për ju, djem, të hapura.



Vajzë,
shallin e kuq
që nëna ma fali, kur dola nga shtëpia,
e nxiva;
nuse,
çorapet e mëndafshta,
dy herë mbathur në dasma,
i nxiva;
nënë,
fustanë e bardhë
për nuset e mbesat e ardhshme
e nxiva;
plakë,
të bardha më mbetën të linjtat
dhe ditët me thinja.

Nuk kishim çfarë të nxinim tjeter.
 Na vranë vëllezërit, burrat, djemtë,
 na shkelën dashurinë dhe dritën,
 na shkelën barkun dhe jetën.

Ngjyra e zezë u përzie me dashurinë.



Emra nuk kishim.

Emrat tanë ishin zverdhur në harresë.
Si u gdhive, moj

Spirovicë,

mirë mëngjezi!

mirë mëngjezi!

Spirovica kërkon një dorë miell:
— ta kthej nesër.

Nes r, po t  mos kishte,

te khente buzegeshje.

Emri yt i zverdhur mbeti i ri,
moj flokëthinjura Spirovicë-Nastasi.

Çarçafé tē larë,
vetëmi.
Erë, shi,
vetëmi.
Hënë,
vetëmi.

Për të pjellë fëmijë gratë,
burrat gjetkë u tretën.

Qyteti i fjetur shtrihej,
hapte qepenat, mbyllte qepenat.
Qepenat-qepalla.

Prapa kësaj përpëlitjeje qepallash,
pritnin nuset dhe vjehrrat,
brenda kësaj përpëlitjeje qepallash
pregatiteshin kohë të reja.



Natë.

Shiu bënte baltë.

Nga dolën këto gjurmë të gjata
mbi shkorsën tonë të vietër?

Në vijat e bardha me gëlqere
deri afër krevatit

baltë.

Këshiu duke larë e stërlarë baltën,
duke rritur fëmijët,
u mplakëm.

Ju do tē thoni c'lidhje ka balta me djemtē.
Pa bijtē asgjë s'do tē kishte lidhje,
as vijat e gëlqeres,
as shkorsa e vjetër.

E derdhëm mbi bijtë gjithë dashurinë,
edhe të zotit edhe të lopëve edhe të bimëve.

Bota filloi të bëhet e madhe,
bota e mbledhur në një filxhan kafeje.

Vijat e shkorsave dhe të hajateve
s'kishte përsë t'i lexonim
ashtu si sot ekranin e prishur të televizorit.

«Duart të mbajnë erë qepë,
këmbët të çojnë në kishë,
petët kurrë s'i grise,
moj Spirovicë».

Sytë shikojnë malin,
zemrën s'e ke në shtëpi,
gjinjtë ushqejnë djalin,
moj Nastasi».

Botën na e bënë të madhe të vegjelit
botën na e bëri të madhe e nesërmja.
Thellësinë e botës e ndjemë,
botën e thellë të gruas një herë.

Në zjarrin e luftës
kohës i ndjemë tik-takun,

Sho~~ge~~.

Kjo ishte liria,
ishte zëri ynë i përjetshëm, i dridhur,
ishte zemra jonë e hapur.

Shoge

u bëmë
mes gjakut.

Ngjyra e kuge u përzie me dashurinë.

Shoge.

Shkorsa t  mbledhura,
krevat  t  prishur
p r t 'u mbartur n  jet  t  reja,
p rjet sish.

Në këtë rrugë të gjatë,
të gjatë, të gjatë,
u bëmë gra,
plotësisht.

MARSI BRENDA NESH

Brenda kurmit tonë fryjnë erëra,
bloqe-bloqe akujt u copëtuan,
gjetën rrugën burime të reja
as papritur dhe as pakujtar.

Brenda kurmit tonë fort u drodhën
ëndrrat shekullore të platisura,
bulëzuan hove krejt të reja,
që të gjitha ne i kishim pritur,

Sepse ne e dinim që, pas shkurtit,
do të vinte marsi brenda nesh,
kjo dëshirë është aq e vjetër
sa ç'është edhe shumë e re.

KUR U RINDERTUAN VARRET E DÉSHMOREVE

Qytetet e vjetra, qytetet e reja
mbartin mbi shpinë
më të mirët bij,
më të mirët.

Gjyshet hapën sëndukët e vjetër
që kanë marrë në pajë
dhe nxorën fotografitë,
fotografitë e djemve të parë,
e djemve të mirë!

Mes shpatullash shokësh
pranë motrave,
pranë baballarëve
janë dëshmorët,
janë dëshmorët
pranë të gjallëve.

Tani fytyrat e bijve të rënë
në varrezat e reja
qëndrojnë në pavdekësinë e lapidarëve.
Mes shpatullash të padukshme,
shpatullat e të gjallëve.

TESERA E RINISE

Tesera e rinisë:
rinia ime e butë, rinia ime e hedhur,
rinia ime e hollë,
aksionet, mbledhjet...

Shoh firmat e shokëve
janë hapat e muajve, të viteve,
rinia ime e parë,
ti ike.

Ja firma e Mulit e rrumbullakët,
ja firma e Ismailit, e gjatë.
Si dridhen e flasin gërmat
nga bankat e shkollës në fshat!

Tesera e rinisë,
rinia ime pa halle,
kushedi kush do të të firmosë me duar të
sigurta.
Jeta kërkon botën time.
Jetës sonë i falem.

PROLOG

Gratë shkundën shtëpitë,
gëzimi shkundte rrugët,
revolucioni fshatrat, qytetet,
bota shkundte shtetet.

Kishte ardhur paqja,
kishte ikur lufta,
ishte dehur dita.
Mos njerëzit thërrisin:
«Poshtë Amerika!»

Gaqevica dëgjonte zhurmën e njerëzve,
Gaqevica dëgjonte zhurmën e mallit,
Gaqevica s'rrinte dot jashtë,
Geqevica s'rrinte dot brenda...

Djemtë u kthyen nga malet,
Gaqi do të kthehej nga mërgimi.
kështu e kish menduar
ditën e bukur të kthimit.

Rrugët — gurë
furrat me bukë
fashot — flamurë.

Kishte ardhur paqja,
kishte ikur lufta,
ishte dehur dita.
Mos njerëzit thërrisinin:
«Poshtë Amerika»?

Njerëzit ngjiteshin, zbrisnin,
po fillonin ditë të reja.
— Gaqi, eja.

Gaqi do të jetë kthyer e ka takuar djemtë,
Gaqi do të jetë kthyer e ka takuar nuset.
Endet Graqovica nëpër rrugë,
endet për Gajin gjersa ngryset.

Ja portat e shtëpive të hapura
dhe çesmat e lagjes të heshtura;
njëlloj qenkan të gjitha,
dhe portat dhe çesmat.

«Ku është shtëpia, ku janë muret e
bardha...»
Gjithë gratë e lagjes kanë nderë çarçafët,

gjithë paskan lyer, gjithë paskan larë,
dhe ajo do të grisë
çarçafët e vetëmisë.

Me pleqërinë u ngatërrua dashuria
e Gaqovica harroi shtëpinë,
në këtë gëzim të parë,
në këtë vjeshtë
duhej hutimi i saj
dhe britma e mallit të djegur.

NE VAJZAT

Ka ikur ajo kohë
kur në skenë ju djemtë luanit Antigonën.

Ka ikur ajo kohë.
Sot ne jemi të lumtura.
Mijëra djem na këndoijnë
(Ne më pak u këndojmë djemvet).

Ne jemi të plotëfuqishme,
sepse së bashku me ju
festojmë ditën e 1 Majit,
së bashku me ju
thyejmë rekorde kombëtare,
sepse së bashku me ju festojmë Nëndorin,
(plus festën e grave
dhe muajin e të rejave).

Ju, djemtë,
përpara se të na propozoni pér fejesë,
mustaqe më mos lini.

Ne do të mbetemi gjithmonë finoke,
ne do të mbetemi gjithmonë
Diana, Afërdita, Antigona.

Neve do t'na i marrin mendjen
ujërat pranverore,
por s'do të çuditemi shumë
nga mustaqet dhe kostumet.
Ne s'kemi dalë konkurseve pér

«missis bota»

dhe as ngjyrat ndërrojmë si kameleoni,
ne u rritëm rrëzë maleve
ose zbritëm nga mali,
me këmbën 38;
ne erdhëm
pér të ecur në qytetet e paqeta,
pér të ecur nëpér rrugët plot zhurmë,
ne erdhëm
pér të ngritur kullat e televizionit
bashkë me djemtë,
pér të vënë drita neonit
në vitrina, ku malet

pasqyrohen dhe retë.

Ju, djem, mos u krekosni
që ne nuk kemi pamje prej Marsi,
por do të vijmë bashkë me ju,
stuhia po të plasë.

Me duart tona «të buta»
do të lidhim plagë të ashpra
dhe do të jemi kudo
bashkë, bashkë, bashkë.

VJESHTA NË ZJARR

Perëndim i verdhë,
perëndim i kuq,
perëndim gri...

Retë kapërcejnë malet si gjigantët e lashtë,
pemët bëhen perëndim i përflakur,
qiejt thërrasin gjigantët zjarrfikës.

Pritni t'i thajë kjo vjeshtë
flokët e mi, që pleksen me shirat e gjata,
flokët e mi të lagur.

M B L E S E R I

Të ulur përbri,
asnjeri nuk di si të rrrijë...
ajo-çorapin e grisur,
ai-dhëmbët e prishur...

O, o, sa çudi,
u takuan të dy përsëri...
ajo-çorapin e zënë
ai-dhëmbët e vënë.

SPIKERE E RADIOS

Spikere e radios,
nga gjithë të panjohurit
ty të njoh më mirë,
pra, s'je e panjohur.

Spikere e radios,
ti përshëndet gjithë njerëzit,
ti je e panjohura ime
e preferuar.

Spikere e radios,
me emrin tim të lutem
thuaju një herë të gjithëve

Mirëmengjerez !

1964

AQ SHUMË MË FLISJE

Aq shumë më flisje për Kont Ugolinin,
për shtegëtimet e Sanços pas ustait
dhe fjalët e tua ku nuk më shpinin,
në çdo vend të botës, në çdo skaj.

Më flisje aq shumë ti për kaltërsinë,
për veten që e quaje atëhere të rritur,
për romantikën, e cila të pëlqente,
për mua që isha akoma e mitur.

Pastaj ti fillove të më flisje për «të»
më rrallë më flisje për Kont Ugolinin,
çudi, romantikën pas dore e le,
e le nëpër ëndrrat që netve shihnim.

Me «të» do të ikësh ti ndonjë natë,
duke marrë valixhen dhe gjëzimin me vete.
Do të marr unë prej teje veç letra pa datë
në ditët e kaltra të vjeshtës së qetë.

GJASHTËMBËDHJETË VJEÇE

Sot mbusha gjashtëmbëdhjetë vjet.
Pashaportën më dhanë këtë ditë.
Sot fluturoj e fluturoj,
sikur pashaporta
është lejëkalimi për në hënë
a në galaktikë,
sikur me të do të zbuloj
të fshehtat e tokës dhe të kibernetikës,
sikur me të do të luaj sinfonitë...

Gjashtëmbëdhjetë vjet mjaftojnë
për të larë këmishën gjithë djersë të babait,
gjashtëmbëdhjetë vjet mjaftojnë
që zemra të rrahë për miliona,
për tokën,
 për lindjet,
 për ditët . .

1964

ANA E FRANKUT

Pas më ndjek shikimi yt, Ana Frank.
Koha ikën. Ti ashtu na mbete.
Ylli yt u lye dje me gjak.
Nuk di aspak se ku u trete.

Pas më ndjek shikimi yt, Ana Frank.
Ti aq shumë jetën e dashurove...
Pse nuk vure emrin tim atje
në ditarin që nuk e tregove?

Shpesh tek ti do të drejtohem, Ana Frank,
që me mua të shohësh hapësirën,
që me mua ti me ndonjë varg
të çash tokën, të çash errësirën.

E K L I P S

A e mban mend kur brodhëm me qelqe
dhe qiellin e pamë me qelqe të nxirë?
Për herë të parë me ngjyra të errëta
bota e madhe shihej më mirë.

A e mban mend kur brodhëm me qelqe
dhe qiellin e pamë me qelqe të nxirë,
diellin dhe hënën, atë mëngjez vere,
si në përrallë i pamë mysafirë?

Kështu edhe ne sot njerezit na panë,
na panë me qelqe,
ne që të dy ishim aq pranë
sa hëna dhe dielli larg janë me vjete.

PRAPA AVLLIVE*

Prapa avllive, futur në qoshe,
janë mbledhur babai dhe tetot.
«Hë çupë, si thua?
Kaluan dy muaj»
Eli ka ulur kokën,
Eli po rri si e huaj.
Tetot numërojnë yjet që shuhën,
tetot e dashura dashurisë i druhën.

Dil nga avllitë dhe eja me ne,
Eli!
s'ke pse ta zgjatësh, Eli.

Pas dhëndurve ne s'do të qepemi,
përmes lotësh, që kanë tradita të lashta,
eja dhe rri në hapësirat e bardha
më e sigurt se prapa avllive të trasha.

1966

* Avlli (Korçë) — mure që rrrethojnë shtëpitë qytetare.

M A R S

Duke shfletuar kalendarët,
shoh ditët rrjeshtuar si ushtarët.
Dalin një nga një nga fletët
dhe mbeten gjithnjë ushtarë

të pranverës.

Nëpër kalendarë
fjalën e vjetër mars
do ta zërë fjala

Marks.

TE DY

Të dy me hap të shpejtë,
duke lënë prapa njëri-tjetrin,

të dy në rrugën e gjatë,
duke gjetur rrugë të shkurtëra,

të dy të panjohur
shkojmë për të takuar dashurinë tonë,

të dy, miqtë më të rinj të qytetit,
dashurinë e madhe mbrojmë.

TË KËRKOVA, ZHULI

Të kërkova, Zhuli,
t'i blatonim Korçës disa dhurata,
për shembull, një shi të çuditshëm,
ku të mos lageshin

vetëm burokratët

Të kërkova, Zhuli,
të thëthinim bashkë
ajrin e mëngjezeve;
mendimet tonë si vesë,
të binin mbi kokët e njerëzve.

Të kërkova, Zhuli,
t'i bënëm vizitë teto Nastasisë
(teto Nastasisë tufa me lugë,
nga dasma e djeshme,
iu kthye në tufë me lule,
me lulëzim të përjetshëm).

Të kërkova, Zhuli,
si kërkohet gjëzimi
nëpër rrugët e çelëta;
të mblidheshim të gjitha
dhe lulet e tetos
t'i vinim në flakët e sertë.

Të kërkova, Zhuli,
të thëthinim bashkë
ajrin e mëngjezeve;
mbi lulet tonë, si vesë,
të binte mendimi i njerëzve.

NË KARPEN

Në Karpën

toka shtrëngon detin në gjiret.
Tokë korriku. Vapë.

Po të mos ishte ky det i gjerë
që përtërihet,
po të mos ishim

djem edhe vajza — ushtarë,
toka e lashtë do të ishte e mplakur.

Y J E T

Yje, Yje, Yje...
S'dua të jem yll kinemaje
kur lumturia ime është e madhe
sa yjet e qiellit që ndrijnë.
S'dua të jem yll kinemaje.
Gjithmonë do të këndoja për yjet
dhe yjet s'do të bien kurrë
si yjet e kinemasë.

1964

1964

ÇDO DITË

Çdo ditë na duket sikur rritemi
dhe rritemi, shoqe,
si rriten lulet dhe degët e pemëve,
si rriten e pleksen gërshtat e flokëve
që na i merr era
dhe na pëlqen kjo erë...

Jemi goca të thjeshta.
Turp na vjen ndonjëherë
t'u lexojmë vargjet të tjerëve,
të kuqojmë baballarët
se mendojmë për dashurinë.

Në këtë rast, përpara atdheut,
më lehtë se përpara baballarëve,
i hapim vargjet dhe zemrat,
vargjet dhe zemrat e bardha.

1967

NË VENDLINDJEN E MAMASË

Po ngjitem përpjetë kalasë.
Mbi pirgjet ka mbirë blerimi.
I dashur më është vendi i mamasë
dhe ky gjylistan i Nezimit.

Ju, mijëra dritare, s'më njihni,
s'e njihni këtë keçen tuaj,
mamanë përditë e shihnit,
dhe mua më keni të huaj.

1964

MENDIMI PRANË VAUT TË DEJËS

Qielli derdhi shirat,
qielli vërtiti turbinat,
qielli mbi ne u hap,
hidrocentral nga lart.

Njerëzit nga qiejt vodhën zjarret,
njerëzit rrëmbyen hidrocentralet,
nga qiejt e pamasë
zbritën mbi tokë fuqitë gjigante.

DHEU ŃSHTË I KUQ

Dheu ăshtë i kuq
pranë lapidarit të Zaho Kokës.
E kuqe,
 e zhveshur,
 e thyer,
 e dridhur
qenka këtu
 klithma e tokës.

D A S H U R I

Njëzet qindarka për të folur me ty,
tridhjetë qindarka për të ardhur tek ti...

Sikur miliona të më jepnin,
s'do të kthehesha mbrapsht nga ti.

K U A J T

Hingëllimën e kuajve e kemi dëgjuar në fusha,
hingëllimën e kuajve e kemi dëgjuar në male,
në monopate të ngushta,
në pluhurin e rrugës së madhe.

Kuajt janë futur në luftëra,
kuajt janë futur në karvane
dhe në libër me një emër të ngatërruar,
Suifti ka futur kuajt.

Në ditët e sotme të zhurmshme
dhe kurdo qoftë në jetë,
si kuaj na hynë trenat,
trenat e hekurt të shpejtë.

Monopatet e ngushta u hapën
dhe shkelëm në të tjerë truaj,
në histori dhe përralla
do të hyjnë trenat si kuaj.

Unë do të bëhem kujdestare e kuajve.
t'u fshij ballin e lagët,
e jonxhë e trifil të lëndinave
t'u sjell në shtallën e vakët.

E qimja e zezë t'u ndrijë
e syve të xhamtë t'u përgjigjem
si më e reja kalorëse,
si mikja e tyre e përditshme.

TE NESERMEN E NENDORIT

Punëtori i komunales, karrocieri,
mbledh gjethet e rëna,
gjethet shumëngjyrëshe që era rrëmbe
në bulevardin e gjatë

«Marsel Kashen».

Majat e plepave zverdhojnë si dielli.
Në shkallët e rrymave të ajrit të vjeshtës,
pezull

gjethet e arta ngelin,
gjethet e fundit që mbledh karrocieri.

Zhurma e karros,
zhurma e bubullimave
mbyten nga zhurma e fishekzarëve të djeshmë
si fishekzarë bien këto gjethe vjeshte.

FLOKËT E GJYSHES

Ë pleks ti gërshetin ngadalë-ngadalë,
gërshetin e vockël, të hollë ngjyrë gri,
që ka në vefëvete me dhjetëra fjalë,
që vjete më parë ish sterë i zi.

E preva gërshetin
dhe ty ta dhurova,

që flokët t'i mbledhësh
mirë gjithmonë,
që në kokën tënde të thinjur dimërore
të mbash këtë copë pranverë vajzërore.

D E S H I R E

Që në skenë i sigurt të ndjehesh,
nga salsa gjysmë e errët
merre, i dashur, vështrimin tim,
vështrimin tim të kthjellët.

Unë t'i njoh shqetësimet e tua.
Sot që po ngjitesh në skenë;
merri, i dashur, trokitjet e mia,
trokitjet e mia të zemrës.

NATË FESTE

Në sheshin e gjerë «Skënderbe»
lumi i njerëzve të rrëmbe.

Në këtë rrjedhë të fuqishme të viteve
ne më tepër i përkasim kësaj dite;

ne jemi ëndrrat e baballarëve
nën qiillin e ulët të fishekzareve.

Qindra reflekse, këtë natë, vërsulen
dhe mbi më të heshturat e botës, mbi muret.

KU I KANË ZEMRAT NJERËZIT

Unë e di ku i kanë zemrat njerëzit.
Një bojaxhi e lë zemrën te muret,
një këngëtar e ka zemrën te zëri,
ti, që qesh bukur,
e ke zemrën te sytë.

MBI KALLDRËM

Në rrugën shtruar me kalldrëm
do të nisem për së shpejti.
Që asnje hap mos të shkojë dëm
do të doja unë në jetë.

Ule të shtrembtën shpinën tënde,
o ti kalldrëm turk,
për mua rruga qoftë e drejtë,
po nisem sot më ngut.

1964

ENDRA

Shpesh në èndrra unë përkundem,
tamam si mbi kolovajzë.
Ndoshta ndokush do të thotë:
«E çuditshme éshtë kjo vajzë».

Këto èndrra janë të njoma,
këto èndrra janë të èmbla,
këto èndrra shkojnë akoma
shumë larg, ku nuk shkel këmba.

Po atje, ku shkelin èndrrat,
do të shkel dhe unë një ditë,
do t'u them: «O, mirëmbrëma,
më në fund tek juve mbërrita».

1964

ERDHI STINA

Erdhi stina e martesave,
erdhi stina e krushqve,
erdhi stina e peshquesheve,
koha e samarëve dhe e mushkave.

Me shkronja varaku vijnë ftesat:
«Kini mirësinë
të na nderoni ditën e diel
me ardhjen tuaj familjarisht».

Po në buzët tona pëshpërit era,
e gëzuar, e marrë
(u trembën mushkat nën samarë).

Në buzët tona pëshpërit era:
Rroftë dashuria e parë!

1967

PEJSAZH

Qielli mbuluar me re:
shi, shi, shi...
Shiu mbi pyllin derdhet
në kodrat karshi.

Pemët e lara,
pemët e dendura të pyllit,
pemët flurore të larta —
furçë për shpirtin tim.

NË VÉRI

Në agjensi, te rruga,
unë u mbështeta tek ti, i dashur: Mirupafshim!
Picërruan sytë kullat.
Malësoret ulën sytë:

— Kurrgja nuk pashë.
Malësorët i ngritën sytë tej horizontit:
— Ç'po shohim, burra!

Unë me fytyrë të gjerë veriore
u mbështeta në gjithë veriun,
në këta malësorë,
në këto malësore.

L U L E T

Margarita Tutulanit

Kushedi sa herë është nisur kjo këngë
dhe asnjëherë s'ka mbetur përgjysmë,
si qëndizma jote në muze në vitrinë,
me lulet e malit, me lulet e fushës.

Nuk e di,
kanë dalë lulet nga qëndizma
për të mbirë në hapësirat tonë,
apo ty të erdhi keq
t'i mblidhje të gjitha.

Vetëm di
që lulet e 5 Majit
m'i ke falur ti.

MOSHATARËT

Dikur më dukeshin gjigantë ushtarët.
Sivjet — moshatarë.
Tani dhe vargjet e mia
i kap ushtria.



LETTER

Mirëdita,
teto dhe xhaxhallarë,
kushurinj të parë,
s'jemi në kohën
paragjinore të njerëzvet
dhe as në kohën
e kuvendit të pleqvet.

Mirëdita,
teto dhe xhaxhallarë,
unë rrugën do ta zgjedh vetë,
nënës do t'ja pëshpërit në vesh,
babait do t'ja them me respekt
dhe rrugën do zgjedh vetë.

Të dashur
Teto dhe xhaxhallarë,
kushurinj të parë,
dua t'u shes akullore fëmijëve,
dua të këndoj koncerteve të majit,
dua t'u ndaj rrogën pensionistëve.

FËMIJNI, FËMIJNI

Midis nesh — si ne,
me zërin e plotë,
me zërin e qetë,
një hero i punës na flet.

Zëri i tij drodhi ajrin e fushave,
zëri i tij u ngjit lart,
zëri i tij zbriti honeve.
I çuditshëm qenka,
ky zë i heronjve.

Fëmijni, fëmijni,
kudo së bashku do të hyjmë
edhe në mes të kësaj fushe të madhe,
ku zëri i heroit
del nga gjoksi im
dhe unë mbushem e mbushem me frymë

DIELLI I MARSIT

Dielli i marsit
ra mbi fytyrat tonë,
e skuqi lëkurën e hollë
të Dhorës,
la arna te gratë shtatzana,
ku më shumë, ku më pak
mbeti tek ne të tjerët
ngjyra e errët.

Dielli i marsit u fut në re,
dielli i marsit hyri tek ne.

STËRGJYSHJA IME DHE ELENA GJIKA

Stërgjyshja ime bujkeshë,
që nuk i njihte as Alpet tonë,
pasi korri,
pasi mbolli,
pasi bëri dhjetë djem,
lule filloi të mbjellë.

Elena Gjika e famshme,
që kushedi sa herë kapërceu Alpe të tjerë,
pasi rralloi letrat me De Radën,
e plakur, lule filloi të mbjellë.

Nën qiej të ndryshëm,
sikur të ishin përbri,
sa shumë folën,
sa lule mbollën.
për ty, Shqipëri!

UNË NUK E DIJA

Në mes të gjelbërimit të thellë të pemëve
ne u ndamë,
se unë nuk e dija që ti ishe njeriu im
i dashur.
Ne u ndamë
por do të takohemi prapë
në muajt e tjerë të verës.

Lulet e ftoit lulëzuan të fundit
edhe në viset e mia,
por lulëzimi i tyre nuk humbi.
Unë po nisem të gjej lulëzimin.
Unë po kthehem tek ti,
midis gjelbërimit.

KËNGA E TË SËMURËVE TË SHËNDOSHË

Vendosëm edhe ne të kemi këngën tonë...
Të shihni edhe ju se qëndrojmë lart,
me botën e shëndoshë takohemi shëndoshë,
bile edhe këtu në spital.

Ne të kirurgjisë,
të kthyer karshi njëri-tjetrit,
bisedojmë me endje
për lajmet e «Zërit të Popullit»,
megjithëse kemi dhembje.

Ne të mushkërive,
të sëmurë «me emër»,
aq të ftohura patëm në shpinë,
sa shpina na u bë zemër.

Ja tani ne të barakave të qosheve,
4-orësh. 6-orësh, invaliditet,
bashkë me cigaret, sapunin dhe furcat,
le t'u japim njerëzve shëndet.

Vendosëm edhe ne të kemi këngën tonë,
botën e shëndoshë të kemi si refren.
Bota e shëndoshë, me krahun e fortë,
në jetën e gjallë të gjithëve na rrëmben.

NUK MË LË BORA TË SHOH

Nuk më le bora të shoh
çatitë e kuqe dhe pemët e zhveshura,
por ndjej si, nën të,
lëviz pranvera.

Flokët e borës
bien e shkrijnë në qepallat e mia,
kaq lot të bukur,
kaq lot të bardhë
mund të pikojnë vetëm nga dashuria.

DITA E TETË E PRANVERËS

Kjo ditë është diçka më e madhe
se sa të dhuruarit e një palë çorapeve.

Mjafton që rrugët
me ngjyrën e kuqe të mbushen,
mjafton që kalendarë të vjetër
mos ngatërrojnë këtë ditë të tetë.

Mjafton

në ditën e tetë të pranverës
burrat të mendohen
e të caktojnë një datë
për festën e tyre të ardhshme,
si e caktuan edhe gratë.

N D A R J A

Para pallatit të madh
vendosa të të pres
deri në gjashtë e një çerek.

Gjashtë e një çerek
brenda në sallën e koncertit shënoi balerina,
gjashtë e një çerek
me dorë shënoi polici i trafikut.

Në sallë njerëzit shihnin vallen.
Rrugën e tyre shihnin maqinat.
Në këtë pritje unë e kuptova:

kjo ishte ndarja.

UNË, GJYSHJA DHE NËNA

Unë,
gjyshja
dhe nëna
jemi natyra.
Secila një pejsazh më vete.
Bien shira,
fryjnë erëra,
ne i thëthimë sikur të ishim të etura,
ne i thëthimë se na trëmb thatësira.

Unë,
gjyshja
dhe nëna
jemi natyra.
Secila një pejsazh më vete.
Në shira të ndryshme,
në të ndryshme erëra,
pellgje të ndryshme
mbi gjokse na mbeten.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Grua (poemë)	3
Marsi brenda nesh	10
Kur u rindërtuan varset e dëshmorëve	11
Tesera e rinisë	12
Prolog	13
Ne vajzat	16
Vjeshta në zjarr	18
Mblesëri	19
Spikere e radios	20
Aq shumë më flisje	21
Gjashtëmbëdhjetë vjeçë	22
Ana Frankut	23
Eklips	24
Prapa avllive	25
Mars	26
Të dy	27
Të kërkova, Zhuli	28
Në Karpen	30
Yjet	31
Çdo ditë	32
Në vendlindjen e mamasë	33
Mendimi pranë Vaut të Dejës	34

Faqe

Dheu është i kuq	35
Dashuri	36
Kuajt	37
Të nesërmen e Nën dorit	39
Flokët e gjyshes	40
Dëshirë	41
Natë festë	42
Ku i kanë zemrat njerëzit	43
Mbi kalldrëm	44
Ëndra	45
Erdhi stina	46
Pejsazh	47
Në veri	48
Lulet	49
Moshatarët	50
Letër	51
Fëmijni, fëmijni	52
Dielli i marsit	53
Stërgjyshja ime dhe Elena Gjika	54
Unë nuk e dija	55
Kënga e të sëmurëve të shëndoshë	56
Nuk më lë bora të shoh	58
Dita e tetë e pranverës	59
Ndarja	60
Unë, gjyshja dhe riëna	61

57171

